



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 1 i Regj.Themeltar
Nr. 1 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Ervin PUPE - Kryesues
Albana BOKSI - Anëtare
Sandër SIMONI - Anëtar

sot më datë 09.06.2021, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen gjyqësore me nr. 11115-01161-2019 regjistri, që ka lidhje me shqyrtimin e rekursit që i përket palëve:

KËRKUES: Arshi Xhelili.

OBJEKTI: Sigurimin e padisë.
Pezullimin e çdo lloj punimesh si veprime gjurmimi e ndërtimi mbi pasurinë trashëgimore të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” të përfitur nga paditësi Arshi Xhelili me vendimin nr. 97, datë 04.03.2016 të KKKP Vlorë, si dhe pezullimin e transaksioneve nga Zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli etj, kthyer me vendimin nr. 117, datë 29.11.1996 të KKKP Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile.

e cila lidhet me çështjen civile të themelit, të regjistruar pranë Gjykatës së Lartë me nr. 11243-01396-2016, datë 27.04.2016 dhe që ju përket palëve ndërgjyqëse si më poshtë:

PADITËS: Arshi Xhelili

I PADITUR: Lefter Gjyli

OBJEKTI I PADISË: Goditjen për falsitetin e vërtetimit të pronësisë datë 04.03.1996 i Hipotekës Vlorë dhe i datës 03.02.1992 dhe urdhërimi i asgjësimit të tyre.
Sigurimi i padisë. Vendosija e masës së pezullimit të veprimeve që kanë lidhje me këtë truall.

BAZA LIGJORE: Neni 202 e 270 i Kodit të Procedurës Civile.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SE LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ervin Pupe mbi kërkesën e palës kërkuese Arshi Xhelili për vendosjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e çdo lloj veprimi mbi pasurinë e tij, pasi është dhënë vendimi nr. 1177, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Vlorë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1.Referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se paditësi Arshi Xhelili i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 22.04.2013, me padinë me objekt të sipërcituar në pjesën hyrëse të këtij akti.

2. Me vendimin nr. 2634, datë 10.12.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

-Rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit Arshi Xhelili me objekt goditje për falsitet të dokumentit si ta pabazuar në ligj dhe në prova.

-Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

3. Me vendimin nr. 1177, datë 27.10.2015, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur:

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 2634, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Kundër vendimit nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka ushtruar të drejtën e rekursit pala paditëse Arshi Xhelili, i cili ka parashtruar këto shkaqe:

- Të dyja vendimet e dhëna nga gjykatat janë të pabazuara në ligj dhe në prova.
- Të dyja gjykatat nuk rezultojnë që të kenë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, në përputhje me parashikimet e nenit 14 dhe 16 të KPC.
- Të dyja gjykatat kanë lejuar kryerjen e shkeljeve procedurale gjatë gjykimit.
- Gjykata e Apelit Vlorë, thjesht ka përsëritur vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe nuk ka argumentuar se përse shkaqet e paraqitura në ankim janë të papranueshme, kohë në të cilën këto shkaqe kishin të bënin me zbatimin e ligjit material.
- Të dyja gjykatat kanë argumentuar se padia duhet të rrëzohet, pasi paditësit i mungon interesi legjitim për t'iu drejtuar gjykatës, si dhe padisë së paraqitur i mungon shkaku ligjor.
- Gjykatat kanë keqinterpretuar vendimin unifikues, pasi, me këtë padi paditësi ka synuar të mbrojë një interes të ligjshëm dhe kushtetues, e cila ka lidhje me të drejtën e pronësisë që i është mohuar paditësit për efekt të veprimeve të paligjshme, mashtrimeve dhe falsifikimeve që ka bërë pala e paditur në këtë gjykim.
- Aktet që janë goditur për falsitet në çështjen objekt shqyrtimi, nuk janë tituj pronësie, por këto akte kanë shërbyer si bazë që pala e paditur të fitojë të drejtën e pronësisë mbi këto prona, pasi nga këto akte, është hequr paragrafi i fundit “*transkriptuar në favor të Marinës Italiane*”.
- Pala paditëse e ka mbështetur pretendimin e tij tek kopja e regjistrimit hipotekor me nr. 171 të vitit 1940, në të cilin konstatohet lehtësisht pretendimi i paditësit për falsifikimin e akteve objekt shqyrtimi.
- Gjykata, në arsyetimin e vendimeve të dhëna ka cituar vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, duke arsyetuar se padisë i mungon shkaku ligjor. Megjithatë, gjykatat nuk kanë mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 3, datë 29.03.2012, në të cilin është përcaktuar se shkaku i padisë

përbëhet nga dy elementë: a) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive; dhe 2) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte.

- Gjykata nuk duhet të ishte mjaftuar në shqyrtimin e kësaj çështje duke u fokusuar vetëm me pjesën hyrëse të padisë, por ajo duhet ta kishte studiuar këtë padi në gjithë tërësinë e saj. Janë kërkime të cilat pala paditëse mund ti ketë parashtruar edhe në pjesën fundore të kërkesë-padisë, pa e parë të nevojshme që ti parashtroj ato në objektin e padisë.
- Nëse gjykatat do të kishin pasur paqartësi në lidhje me padinë e ngritur, ato kishin detyrimin që referuar nenit 158/a të KPC ti kërkonin palës paditëse shpjegime rreth shkakut të ngritjes së padisë, duke qartësuar edhe natyrën e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.
- Gjykata, nëse do të kishte konstatuar se padisë së paraqitur i mungonte shkak ligjor, kishte detyrimin që në seancë përgatitore të orientonte paditësin rreth të metës së padisë, duke i kërkuar sqarime dhe shpjegime se cili ishte realisht shkak ligjor i ngritjes së kësaj padie. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë jo vetëm që nuk ka përmbushur këto detyrime të saj, por pas disa muajsh proces gjyqësor rrëzon padinë me argumentin se mungon shkak ligjor i ngritjes së saj.
- Të dyja gjykatat kanë arritur në konkluzionin se mosmarrëveshja e pronësisë midis palës paditëse dhe palës së paditur është zgjidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Megjithatë asnjë prej këtyre gjykatave nuk ka mbajtur në vëmendje faktin se në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 3/2012, Gjykata e Lartë ka pranuar faktin se mund të ketë disa padi me objekte të njëjta, por shkak ligjor i ngritjes së tyre të jenë të ndryshme.
- Për këtë arsye, pala paditëse kishte të drejtë që të parashtronte para gjykatës së cili ishte shkak ligjor i ngritjes së kësaj padie dhe cila ishte e drejta konkrete që ai kërkonte të mbronte nëpërmjet saj. Në rastin konkret, pala paditëse ka kërkuar deklarinimin e falsitetit të dokumentave të pronësisë së lëshuara në emër të palës së paditur, nëpërmjet të cilave i është mohuar paditësit e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme që pasqyrojnë këto akte.
- Nëpërmjet kësaj padie, pala paditëse ka kundërshtuar faktin juridik se trashëgimtarët ligjorë të Kristaq Gjylit nuk e kanë humbur të drejtën e pronësisë në vitin 1940 nëpërmjet sekuestrimit, por e kanë humbur atë për shkak të transkriptimit të kësaj prone në favor të Marinës Italiane.
- Përfundimisht, pala paditëse Arshi Xhelili i ka kërkuar Gjykatës së Lartë:
-Prishjen e vendimit nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

5. Me shkresën nr. 1137 Prot, datë 05.06.2020, paditësi Arshi Xhelili i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën për sigurimin e padisë dhe pezullimin e çdo lloj punimi sipas objektit të cituar në pjesën hyrëse, duke pretenduar këto shkaqe:

- Pala e paditur ka filluar të kryejë punime edhe brenda pronës së palës paditëse në sipërfaqen prej 700 m², të cilën paditësi e ka fituar nëpërmjet vendimit nr. 97, datë 04.03.1996 të KKKP Vlorë.
- Brenda kësaj sipërfaqeje, pala paditëse ka edhe një ndërtesë (ish-banesa), e cila rrezikon të shembet nga gërmimet në thellësi që po kryen pala e paditur.
- Në kushtet kur çështja ka një kohë të gjatë që është regjistruar pranë Gjykatës së Lartë dhe ende nuk është marrë një vendim në lidhje me të, pala e paditur ka filluar të kryejë gërmime me qëllim hakmarrjen ndaj paditësit, i cili ka paraqitur padi për deklarinimin e falsitetit të dokumentave të përdorura prej tij.

- Dëmi që po i shkaktohet palës paditëse është shumë i madh dhe i parikuperueshëm, pasi nga gërmimet që po kryhen rrezikohet që ndërtesa të shembet dhe për këtë arsye, pala paditëse ka të drejtë që ti kërkojë gjykatës vendosjen e sigurimit të padisë, sipas parashikimeve të nenit 202 të KPC. Për këtë arsye, bashkëlidhur kësaj kërkesë po vihen në dispozicion edhe akte shkresore provuese që provojnë këtë fakt.
- Pala paditëse po vijon që të kryejë ndërtime me qëllim që të përvetësojë përfundimisht një pasuri të paluajtshme, të cilën e ka përfituar me akte të falsifikuara.
- Nga këto akte të falsifikuara, pala e paditur ka përfituar edhe një sipërfaqe prej 300 m², e cila ka qenë në pronësi të palës paditëse në këtë gjykim. Për të provuar këtë pretendim të tij, pala paditëse ka depozituar bashkëlidhur kësaj kërkesë edhe një vendim të Prokurorisë së Rrethit Vlorë të datës 16.12.2004, me të cilin është provuar fakti se, pala e paditur ka përdorur një dokument të falsifikuar në KKKP Vlorë për të fituar titullin e pronësisë mbi pasurinë objekt shqyrtimi.
- I padituri Lefter Gjyli ka përdorur disa dokumente të falsifikuara për të rishikuar dhe ndryshuar një vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Që Kristaq Gjyli është zhveshur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen prej 50 vreten (61,000 m²) tregohet edhe nga një dokument pronësie i nxjerrë nga ASHQ Tiranë. Në këtë dokument, nuk rezulton që të jetë pasqyruar pronësia e këtij subjekti mbi pasurinë tokë bujqësore dhe ullishte në masën e 50 vreten (çertifikatë e pronësisë se K.Gjylit e vitit 1941).
- Referuar disa dokumenteve shkresore rezulton e provuar se familjes Gjyli i është hequr e drejta e pronësisë mbi këtë pronë, për shkak të borxheve që ai ka pasur ndaj shtetit, por që të kundërtën e këtij fakti, ka arritur ta sigurojë me një vendim gjyqësor dhe me dokumente të falsifikuara.
- Në kushtet kur aktualisht ekziston nevoja e domosdoshme dhe urgjenca, pasi ka dyshime serioze për falsifikimin e dokumenteve të cilat janë thelbësore për zgjidhjen e çështjes, gjykata duhet të vendosë sigurimin e padisë, pasi me veprimet e kryera nga pala e paditur rrezikohet që e drejta që kërkon të mbrojë pala paditëse në këtë gjykim të bëhet e pamundur.

6. Sërisht pala paditëse Arshi Xhelili i është drejtuar Gjykatës së Lartë me shkresën nr. 898 Prot, datë 18.03.2021, duke pretenduar sigurimin e padisë dhe pezullimin e çdo lloj punimi mbi pasurinë truall objekt shqyrtimi, duke pasqyruar të njëjtat shkaqe si në kërkesën e paraqitur në datën 05.06.2020.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), pasi shqyrtoi kërkesën e palës kërkuese Arshi Xhelili për: (i) vendosjen e masës së sigurimit të padisë; (ii) pezullimin e çdo lloj veprimi mbi pasurinë e tij trashëgimore mbi pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” të përfituar me vendimin nr. 97, datë 04.03.2004 të KKKP Vlorë; (iii) pezullimin e trasaksioneve nga Zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli etj, analizoi shkaqet e paraqitjes së kësaj kërkesë si dhe identifikoi dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin objekt shqyrtimi, arrin në konkluzionin se kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore në Kodin e Procedurave Civile dhe për këtë arsye, nuk duhet të pranohet.

8. Nga shqyrtimi i kërkesës së kërkuesit Arshi Xhelili, akteve shkresore bashkëlidhur saj, si dhe të dhënave që japin aktet e administruara në dosje, ka rezultuar se pala kërkuese Arshi Xhelili, në datën 22.04.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me padinë me objekt: *“Goditjen për falsitet të vërtetimit të pronësisë datë 04.03.1996 të Hipotekës Vlorë dhe të datës 03.02.1992, si dhe urdhërimi i asgjësimit të tyre. Sigurimi i*

padisë. Vendosja e masës së pezullimit të veprimeve që kanë lidhje me këtë truall". Kjo çështje është shqyrtuar fillimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 2634, datë 10.12.2013, me të cilin është vendosur rrezimi i padisë. Këtë vendim pala paditëse e ka ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 1177, datë 27.10.2015 ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pala paditëse rezultoi të ketë ushtruar të drejtën e rekursit ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, i cili ende nuk ka përfunduar së shqyrtuari me vendim përfundimtar nga ana e Gjykatës së Lartë.

9. Gjatë kohës që çështja e themelit ka vijuar të jetë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, pala paditëse i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën objekt gjykimi, duke pretenduar vendosjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e kryerjes së çdo veprimi mbi pronën e tij tokë truall, të përfutur me vendimin nr. 97, datë 04.03.2016 të KKKP Vlorë. Gjithashtu, pala kërkuese ka pretenduar edhe pezullimin e çdo veprimi trasaksioni nga ana e ASHK Vlorë në lidhje me pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli. Në kërkesën objekt shqyrtimi, kërkuesi Arshi Xhelili ka pretenduar se ka ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi kjo gjykatë, ashtu si edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk e ka kuptuar natyrën e vërtetë të mosmarrëveshjes, duke e rrezuar padinë e tij pa kuptuar shkakun ligjor për të cilën ishte ngritur ajo.

10. Gjithashtu, pala kërkuese ka pretenduar se shtetasi Lefter Gjyli (i cili në gjykimin e themelit ka pasur cilësinë e palës së paditur), ka filluar të kryejë punime duke u futur brenda pronës së palës paditëse në sipërfaqen prej 700 m², të cilën, paditësi e ka fituar nëpërmjet vendimit nr. 97, datë 04.03.1996 të KKKP Vlorë. Pala kërkuese ka pretenduar se brenda kësaj sipërfaqeje ai ka edhe një ndërtesë (ish-banesa), e cila rrezikon të shembet nga gërmimet në thellësi që po kryen shtetasi Lefter Gjyli. Për këtë arsye, me qëllim parandalimit e një dëmi shumë të madh dhe të parikuperueshëm, pasi nga gërmimet që po kryhen rrezikohet të shembet ndërtesa e palës kërkuese, ky i fundit, i është drejtuar Gjykatës së Lartë për vendosjen e masës së sigurimit të padisë sipas parashikimeve të nenit 202 të KPC, duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë edhe dokumentacionin përkatës.

11. Kolegji, fillimisht çmon të ndalet dhe të sqarohet faktin se, pavarësisht mënyrës se si pala kërkuese ka renditur shkaqet ligjore për paraqitjen e kësaj kërkesë, ka formuluar objektin e kërimit në pjesën hyrëse të saj, si dhe ka përcaktuar bazën ligjore mbi të cilën ajo ka pretenduar se mbështet kërkimin, është detyrë e gjykatës që të identifikojë drejt mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, shkakun e vërtetë ligjor të paraqitjes së kësaj kërkesë, si dhe bazueshmërinë e saj tek dispozitat procedurale ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e saj. Ky qëndrim, gjen referencë të plotë ligjore jo vetëm në përcaktimet e nenit 16 të KPC, por edhe në qëndrimin që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 3/2012, në të cilën janë shprehur se: "*...gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj*".

12. Bazuar sa më sipër, Kolegji, pasi ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, si dhe ka analizuar në tërësi dhe në veçanti të gjitha pretendimet e paraqitura nga kërkuesi, aktet shkresore bashkëlidhur saj, aktet dokumentare të administruara në dosjen gjyqësore të themelit, për të cilën është dhënë vendimi nr. 1177, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe me të cilën lidhet kjo kërkesë, si dhe duke marrë në analizë të gjitha dispozitat procedurale të zbatueshme, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Arshi Xhelili ka kërkitime komplekse, të cilat, edhe pse në themel të tyre kanë si qëllim mbrojtjen e përkohshme të drejtave të palëve dhe janë në funksion të kërkitimeve themelore, janë kërkitime që i përkasin fazave të ndryshme procedurale të gjykimin, si dhe rregullohen sipas dispozitave ligjore të posaçme.

13. Në kërkesën objekt shqyrtimi, kërkuesi Arshi Xhelili ka parashtruar dy kërtime të ndryshme nga njëra-tjetra. Kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë parashikuar nga neni 202 i KPC, si dhe kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë parashikuar nga neni 479 I KPC, janë dy kërtime me karakter emergjent dhe përbëjnë masa të përkohshme në funksion të realizimit të dy mjeteve procedurale që palët kanë për të mbrojtur të drejtat e tyre ligjore, në dy faza dhe shkallë të ndryshme të procesit gjyqësor. Kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë është kërkim dytësor dhe është në funksion të kërimit themelor, i cili mbrohet nëpërmjet mjetit procedural të padisë para gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, ndërsa, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, është kërkim dytësor dhe është në funksion të kërimit themelor të mbrojtur nëpërmjet mjetit procedural të rekursit, i cili paraqitet dhe shqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

14. Për shkak të këtyre karakteristikave si dhe faktit që këto kërtime i referohen mjeteve procedurale të ndryshme, fazave të ndryshme të procesit gjyqësor, si dhe shkallëve të ndryshme të gjykimit ku ato mund të paraqiten, këto kërtime nuk mund të qëndrojnë së bashku e për rrjedhojë, nuk mund të shqyrtohen nga e njëjta gjykatë. Megjithatë, në kushtet kur pala i është drejtuar gjykatës me kërkesë duke pretenduar mbrojtjen e një të drejtë të ligjshme, Kolegji vlerëson se është detyrë e tij që ti japë përgjigje palës në lidhje me kërkitet e tij, që kanë të bëjnë me: (i) kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e çdo lloj punimesh si veprime gërmimi e ndërtimi mbi pasurinë trashëgimore të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” të përfituar nga paditësi Arshi Xhelili me vendimin nr. 97, datë 04.03.2016 të KKKP Vlorë sipas përcaktimeve të nenit 202 të KPC; (ii) kërkesën për pezullimin e transaksioneve nga Zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli etj, kthyer me vendimin nr. 117, datë 29.11.1996 të KKKP Vlorë, e cila në thelb ka të bëjë me pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1177, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Vlorë, sipas përcaktimeve të nenit 479 të KPC.

15. Në kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Arshi Xhelili është pretenduar vendosja e masës së sigurimit të padisë sipas përcaktimeve të nenit 202 të K.Pr.Civile, duke u pretenduar pezullimi i çdo lloj veprimi të kryer nga shtetasi Lefter Gjyli për gërmime dhe ndërtime mbi pronën e kërkuetit, kërkesë e cila ka natyrë dytësore dhe është në funksion të kërimit themelor, i cili realizohet nëpërmjet mjetit procedural të padisë. Në lidhje me këtë çështje, fillimisht Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se, padia është mjeti procedural që shqyrtohet në gjykatën e shkallës së parë, sipas përcaktimeve të nenit 41 të KPC, në të cilin përcaktohet se: *“Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”*. Referuar rregullave proceduralë të gjykimit, shqyrtimi gjyqësor i padisë përfundon kur vendimi i dhënë nga gjykata merr formë të prerë, sipas përcaktimeve të nenit 451 të KPC, në të cilin është parashikuar se: *“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij; b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar; ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë”*.

16. Bazuar sa më sipër, kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, është një kërkesë që ka karakter emergjent dhe duhet të shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë sipas parashikimeve të nenit 202 të KPC, në të cilin parashikohet se: *“Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë”*. Gjithashtu, Kolegji mban në vëmendje faktin se, paraqitja e kësaj kërkesë mund të bëhet nga pala paditëse deri sa padia nuk është shqyrtuar me një vendim të formës së prerë, gjë e cila përcaktohet qartësisht në nenin 203 të KPC, në të cilin është parashikuar se:

“Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj. Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi”.

17. Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit të padisë është një kërkesë dytësore, e cila parashtrohet dhe merret në shqyrtim në funksion të kërimit kryesor në padi dhe ndjek fatin e tij. Ky konkluzion, gjen mbështetje të plotë tek parashikimet e nenit 55 të KPC, në të cilin parashikohet se: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”.* Për këtë arsye, Kolegji arrin në konkluzionin se, çdo kërkesë dytësore e cila lidhet me kërkimin kryesor, është në funksion dhe ndjek fatin e tij, duhet të paraqitet dhe të merret në shqyrtim nga gjykata që shqyrton kërkimin themelor.

18. Referuar përcaktimeve të nenit 202 të KPC, shqyrtimi i kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, duhet të bëhet ose nga gjykata që do të shqyrtojë themelin e padisë (në rastin kur kërkesa për sigurimin e padisë depozitohet para depozitimit të padisë), ose nga gjykata që po shqyrton themelin e çështjes e cila sipas fazës procedurale të gjykimit mund të jetë ose gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit (referojuni 204 të KPC). Referuar përcaktimeve të KPC, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë që kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë të paraqitet nga pala paditëse përpara se kjo palë të paraqesë padinë e themelit, pra përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor i aj, ose pasi e ka paraqitur padinë e themelit dhe çështja nuk ka përfunduar së shqyrtuari me një vendim të formës së prerë. Në këtë kuptim, kërkesa për të vendosur masën e sigurimit të padisë nuk mund të paraqitet pasi çështja është shqyrtuar në themel të saj me një vendim të formës së prerë.

19. Referuar përcaktimeve të nenit 451/a të KPC, vendimet e formës së prerë janë vendime të ekzekutueshme dhe për këtë arsye ato janë të detyrueshme për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Për këtë arsye, pas dhënies së këtyre vendimeve, palët nuk mund të ngrenë pretendime apo të paraqesin kërtime dytësore të cilat i takojnë shqyrtimit të çështjes në themel të saj pranë gjykatave më të ulëta (shkalla e parë dhe apel), pasi faza procedurale e paraqitjes së tyre ka përfunduar. Gjithashtu, Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, pavarësisht faktit se vendimet e gjykatës së apelit kundërshtohen në Gjykatën e Lartë sipas përcaktimeve të nenit 472 e vijues të KPC, këto vendime nuk e humbasin cilësinë e tyre si vendime përfundimtare dhe as efektet e tyre si vendime të ekzekutueshme (tituj ekzekutiv sipas përcaktimeve të nenit 510/a të KPC). Në këtë kuptim, paraqitja e rekursit në Gjykatë të Lartë, nuk pezullon efektet e këtyre vendimeve dhe as ndryshon cilësinë e tyre si vendime përfundimtare, deri në momentin që Gjykata e Lartë i shfuqizon ato vendime, apo merr vendime në kuptim të nenit 479 të KPC.

20. Bazuar sa më sipër, të vetmet kërkesa procedurale që palët mund të bëjnë në Gjykatën e Lartë pas ushtrimit të rekursit ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e apelit është kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit apo revokimit të vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 479 të KPC. Çdo kërkesë tjetër procedurale, e cila lidhet me kërtime dytësore dhe që lidhen ngushtësisht me kërkimin kryesor, pra me themelin e gjykimit, nuk mund të paraqiten para Gjykatës së Lartë, pasi vendimi i dhënë nga gjykata e apelit është vendim i formës së prerë edhe pse ndaj tij është ushtruar rekurs sipas përcaktimeve të KPC.

21. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, kërkesa e kërkuarit Arshi Xhelili për të vendosur masën e sigurimit të padisë, është paraqitur pasi

është dhënë vendimi nr. 1177, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili përbën vendim të formës së prerë në kuptim të nenit 451 të KPC. Në këtë kuptim, kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë është paraqitur pasi ka përfunduar shqyrtimi i themelit të gjykimit në të dy shkallët e gjykimit, duke ardhur në kundërshtim me përcaktimet e nenit 203 të KPC. Kolegji vlerëson të qartësojë faktin se kërkesa e paraqitur nga pala kërkuese nuk gjen zbatim as sipas përcaktimeve të nenit 209 dhe 470 të KPC, pasi sipas këtyre dispozitave, Gjykata e Lartë shqyrton ankimin e veçantë të palëve që ka të bëjë me kundërshtim e vendimeve të ndërmjetme, pra gjatë kohës që themeli i gjykimit nuk është përfunduar së shqyrtuari me një vendim të formës së prerë.

22. Në rastin objekt shqyrtimi rezulton tërësisht e provuar se shqyrtimi i themelit ka përfunduar me një vendim të formës së prerë dhe për këtë arsye, kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë nuk lejohet që të ngrihet para Gjykatës së Lartë, e cila nuk shqyrton themelin e gjykimit (pra vlerësimin e provave dhe të fakteve), por shqyrton vetëm pretendimet e palëve që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit (procedural ose material). Për këtë arsye, kjo kërkesë nuk mund të pranohet, pasi ligji procedural e ndalon paraqitjen e saj në këtë fazë të gjykimit.

23. Gjithashtu, Kolegji vlerëson të theksojë faktin se, në rast se kërkuesi Arshi Xhelili pretendon se ka një shkak tjetër ligjor për të ngritur padi ndaj shtetasit Lefter Gjyli, të ndryshëm nga ajo për të cilën ka ngritur padinë me objekt *“goditjen për falsitet të dokumentit”*, e cila është shqyrtuar me vendimin nr. 1177, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Vlorë, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tij të ligjshme që pretendon se po i shkelen nga punimet apo gërmimet që po kryhen brenda pronës së tij nga shtetasi Lefter Gjyli, kjo palë duhet të përdorë mjetet e tjera ligjore që i njeh ligji në përputhje me përcaktimet e nenit 451/a, paragrafi i dytë, si dhe ti adresojë kërkesat e tij pranë gjykatës së rrethit gjyqësor në territorin ku ndodhet pasuria e paluajtshme në përputhje me përcaktimet e nenit 202 e vijues të KPC.

24. Kolegji, në analizë të shkakut ligjor të paraqitjes së kësaj kërkesë, si dhe pretendimeve që kjo palë ka paraqitur në kërkesën objekt shqyrtimi, vlerëson se pala paditëse në këtë gjykim ka pretenduar edhe pezullimin e transaksioneve nga ana e ASHK Vlorë mbi pasurinë e regjistruar në emër të shtetasit Lefter Gjyli, kërkesë e cila, lidhet dhe është në funksion të rekursit që kjo palë ka ushtruar para Gjykatës së Lartë ndaj vendimit nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kërkesa për pezullimin e një vendimi të formës së prerë, është një kërkesë që kryhet sipas përcaktimeve të nenit 479 të KPC, në të cilën përcaktohet se: *“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.2. Kërkesa për pezullim parashtrohet në rekurs ose më vite.Gjykata e Lartë merr masat e nevojshme që kërkesa t'i njoftohet palës tjetër dhe kërkesa të gjykohet sa më shpejt. Pala ka të drejtë të parashtrrojë me shkrim brenda tre ditëve, nga e nesërmja e marrjes dijeni mbi kërkesën për pezullim, argumentet e saj dhe kërkimet....”*.

25. Kolegji vlerëson të theksojë se masa e përkohshme e pezullimit të ekzekutimit të vendimit zbatohet vetëm ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë që janë tituj ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të KPC. Që një vendim gjyqësor të plotësojë kushtet për të qenë titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të KPC , ai duhet të përmbajë një detyrim të caktuar (*vendim kondemnator*), i cili, për tu realizuar kërkon kryerjen e një veprimi të caktuar. Mungesa e përcaktimit të të drejtave apo detyrimeve, të cilat mund të realizohen nëpërmjet kryerjes së një veprimi të caktuar, bëjnë që vendimi gjyqësor të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë, por jo titull ekzekutiv sipas përcaktimeve të nenit 510/a të KPC. Për këtë arsye, nëse vendimi gjyqësor nuk plotëson kushtet për të qenë titull ekzekutiv, atëherë edhe kërkesa e

parashikuar nga neni 479 i KPC, për të kërkuar pezullimin e ekzekutimit të tij është i papranueshëm, pasi pa pasur titull ekzekutiv nuk ka mundësi që të vendoset pezullimi i ekzekutimit të tij.

26. Në rastin objekt shqyrtimi, vendimi nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është rrëzuar padia e ngritur nga paditësi Arshi Xhelili, nuk përbën një titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të KPC, për shkak se: (i) ky vendim ka karakter deklarativ, pasi me të është shqyrtuar një padi deklarative sikundër është “*goditja për falsitet i aktit*”; (ii) vendimet deklarative nuk mund të vihen në ekzekutim, pasi nga natyra që kanë janë të paekzekutueshëm; (iii) vendimet me të cilat rrëzohet padia, nuk përmbajnë një të drejtë apo detyrim të përcaktuar, me qëllim që ekzekutimi i tyre të realizohet nëpërmjet kryerjes së një veprimi konkret.

27. Për Kolegjin, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Arshi Xhelili për të vendosur pezullimin e transaksioneve nga Zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli etj, kthyer me vendimin nr. 117, datë 29.11.1996 të KKKP Vlorë, në thelb të saj, pavarësisht formulimit, përbën kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në kuptim të nenit 479 të KPC. Kjo kërkesë e palës kërkuese, përbën një mjet procedural në këtë fazë të gjykimit, me të cilin pala synon që të marrë një masë të përkohshme në mbrojtje të interesave të saj ligjore, me qëllim që të mos pësojë një dëm të rëndë dhe të parikuperueshëm, të cilin, ka pretenduar që ta realizojë me rekursin që ka ushtruar ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë para Gjykatës së Lartë. Megjithatë, Kolegji arrin në konkluzionin se kjo kërkesë nuk ka bazueshmëri ligjore në kuptim të nenit 479 të KPC, përsa kohë vendimi nr. 1177, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk përbën titull ekzekutiv sipas përcaktimeve të nenit 510/a të KPC.

28. Për gjithë sa është arsyetuar më sipër, Kolegji vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Arshi Xhelili, me objekt: “*Vendosjen e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimin e çdo lloj punimesh si veprime gjurmimi e ndërtimi mbi pasurinë trashëgimore të pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” të përfitur nga paditësi Arshi Xhelili me vendimin nr. 97, datë 04.03.2006 të KKKP Vlorë, si dhe pezullimin e trasaksioneve nga Zyra e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për pasurinë e regjistruar në emër të palës së paditur Lefter Gjyli etj, kthyer me vendimin nr. 117, datë 29.11.1996 të KKKP Vlorë*”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile.

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala kërkuese Arshi Xhelili.

Tiranë, më 09.06.2021

ANËTARE

ANËTAR

KRYESUES

Albana BOKSI

Sandër SIMONI

Ervin PUPE